



AKADEMIA
Profesionale E BIZNESIT

Aneksi Nr. 8

Raporti i Auditimit të Jashtëm

Në

Akademisë Profesionale të Biznesit



Grant Thornton

An instinct for growth™

№. 118/1 Prot.

Pasqyrat financiare

Akademia Profesionale e Biznesit Sh.p.k

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Përmbajtje

Raporti i Audituesit të Pavarur	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar	5
Pasqyra e Përformances Financiare	6
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto	7
Pasqyra e Flukseve Monetare	8
Shënimet për Pasqyrat Financiare	9



Grant Thornton

An instinct for growth™

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr. Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D, Shk. B,
Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 58 560
www.grantthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për drejtimin e Akademia Profesionale te Bisnesit Sh.p.k

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Akademise Profesionale te Bisnesit Sh.p.k ("Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar në 31 Dhjetor 2015, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabel dhe të tjera shënime shpjeguese.

Përgjegësia e drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegësia e audituesit

Përgjegësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të atyreshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të Shoqërisë mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të Shoqërisë, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencia e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë, më 31 dhjetor 2015, dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Grant Thornton sh.p.k.

Elindina Kocina, FCA


Tiranë, Shqipëri
13 Prill 2016


Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2015 (Shuma në LEK)	31 dhjetor 2014 (Shuma në LEK)
Aktivet Afatshkurtra			
Mjete Monetare	4	17,746,329	10,119,848
Llogari të arkëtueshme	5	63,972,109	53,945,820
Llogari të tjera të arkëtueshme	6	250,468	447,328
Inventari	7	116,318	32,191
Parapagime dhe shpenzime të shtyra		-	1,660,000
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		82,085,244	66,225,186
Aktivet Afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	8	17,483,652	20,875,578
Aktivet afatgjata jo materiale	9	540,400	743,050
Totali i Aktiveve Afatgjata		18,024,052	21,618,628
Totali i Aktiveve		100,109,296	87,843,814
Pasivet dhe Kapitali			
Detyrimet Afatshkurtra			
Llogari të pagueshme furnitorëve	10	698,204	224,113
Të pagueshme ndaj punonjësve	11	3,147,252	2,402,110
Detyrime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore		796,385	517,593
Detyrime tatimore	12	1,855,706	1,024,862
Të drejta e detyrime ndaj ortakëve		5,382,737	33,248,737
Të ardhura të shtyra		69,971,161	44,078,649
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		81,751,445	81,496,054
Kapitali Neto			
Kapitali i paguar		100,000	100,000
Rezerva ligjore		312,388	50,842
Fitimet e pashpëmdara		5,935,371	966,003
Fitimi (Humbja) e vitit financiar		12,010,092	5,230,914
Totali i Kapitalit Neto		18,357,851	6,347,760
Totali i Pasiveve dhe Kapitali		100,109,296	87,843,814

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Akademia Profesionale e Biznesit Sh.p.k me 22 Mars 2016 dhe firmuar për llogari të tyre nga:


Ardi Bezo
Adminstrator




Bledi Bezo
Kontabilist

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9-18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Pasqyra e Përformancës Financiare

	Shënime	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Te ardhurat			
Shtjet neto	15	70,636,370	50,162,327
Te ardhura të tjera		3,551,201	1,314,015
Totali i të ardhurave		74,187,571	51,476,342
Shpenzimet			
Malra, lëndë të para dhe shërbime		(748,511)	(186,744)
Shpenzime personale	16	(38,125,741)	(17,785,040)
Shpenzime të tjera	17	(16,754,288)	(22,099,852)
Amortizimet dhe zhvierësimet		(3,875,425)	(5,125,361)
Totali i Shpenzimeve		(59,503,943)	(45,196,997)
Fitimi/(humbja) nga veprimtaritë kryesore		14,683,628	6,279,345
Te ardhurat dhe shpenzimet financiare:			
Fitimet (Humbjet) nga kursi këmbimit		341,307	157,554
Shpenzime për interesa huaje		(54,774)	(29,864)
Te ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		(836,173)	(122,823)
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		(551,640)	4,887
Fitimi/(humbja) para tatimit		14,131,988	6,284,212
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18	(2,121,896)	(1,053,298)
Fitimi/(humbja) neto e vitit financiar		12,010,092	5,230,914
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Total i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		12,010,092	5,230,914

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shëniet shpjeguese në faqet 9-18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali	Rezerva Ligjore	Fitimi i pashpërdarë	TOTALI
	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë
Më 1 Janar 2014	100,000	18,052	998,793	1,116,845
Rritje e rezerves ligjore	-	32,790	(32,790)	-
Fitim/humbja neto i vitit	-	-	5,230,914	5,230,914
Më 31 Dhjetor 2014	100,000	50,842	6,196,917	6,347,760
Pozicioni me 1 Janar 2015	100,000	50,842	6,196,917	6,347,760
Rritje e rezerves ligjore	-	251,546	(251,546)	-
Fitim/humbja neto i vitit	-	-	12,010,092	12,010,092
Më 31 Dhjetor 2015	100,000	312,388	17,945,463	18,357,851

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9-18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Pasqyra e Flukseve Monetare

	Shënime	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Fitimi/Humbja para tatimit		14,131,988	6,294,212
Rregulime për :			
Amortizimin		3,875,425	5,125,381
Rënie/(Rritje) në logari të arkëtueshme		(10,026,288)	(5,028,681)
Rënie/(Rritje) në logari të tjera të arkëtueshme		196,840	43,302
Rënie/(Rritje) në tepicën e inventarit		(84,127)	(19,318)
Rënie/(Rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra		1,680,000	4,480,000
(Rënie)/Rritje në logari të pagueshme furnitoreve		374,091	(45,941)
(Rënie)/Rritje të pagueshme ndaj punonjësve		745,142	2,076,721
(Rënie)/Rritje në detyrime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore		276,792	517,593
(Rënie)/Rritje në të drejta e detyrime ndaj ortakëve		(27,866,000)	(7,445,701)
(Rënie)/Rritje në të ardhura të shtyra		25,892,512	(4,531,648)
Tatim mbi fitimin i paguar		(1,291,043)	(969,011)
Mjete Monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		7,907,331	486,889
Fluksi i parave nga veprimtaria investuese			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(280,850)	(1,612,250)
Shitje/Nxjerrje jashtë përdorimit		-	3,616,000
Mjete Monetare neto të përdorura në veprimtaritë investuese		(280,850)	2,003,750
Rritja / rënia neto e Mjeteve Monetare		7,626,481	2,490,639
Mjetet Monetare në fillim të periudhës kontabël		10,119,848	7,629,209
Mjetet Monetare në fund të periudhës kontabël		17,746,329	10,119,848

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9-18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Shënimet për Pasqyrat Financiare

1. Të Përgjithshme

Shoqëria Akademia Profesionale e Biznesit Sh.p.k ("APB" ose "Shoqëria") është regjistruar në QKR, me nr. NIPT-i L02401014C. Ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2011, dhe funksionon në konformitet me ligjin Nr.9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregëtare", statutin e saj dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Akademia Profesionale e Biznesit, është krijuar në zbatim të ligjit Nr. 9741 datë 21.05.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë dhe funksionon bazuar në VKM, Nr. 651 datë 14.09.2011 "për liçencimin e "Akademië Profesionale të Biznesit". Të gjitha programet mësimore të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë dhe i Drejtësisë, pranë APB-së, janë të akredituara, bazuar në Urdhrin Nr.500, datë 18.10.2012/ Nr. 545, datë 13.11.2012 "Për akreditimin e programeve të studimit Bachelor, Master Profesional dhe Master i Shkencave", të lëshuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Shqipërisë.

APB ka zhvilluar projektin e vet strategjik në sfondin e veprimtarisë kombëtare në arsim, për zgjerimin e demokratizimit të reformës institucionale me vështrim ndaj modernizimit dhe integritimit evropian. Programet e studimit në Akademinë Profesionale të Biznesit janë të hartuara konform kërkesave të Kartës së Bolonjës. Ato mundësojnë transferimin e krediteve dhe nxisin lëvizshmërinë akademike edhe të partnerët jashtë vendit.

2. Bazat e Përgatitjes së Pasqyrave

2.1 Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.2 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjyqimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Aktive afatgjata materiale

(i) *Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) *Kostot e mëparshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Amortizimi vjetor i aktiveve është si më poshtë:

Aktive të qëndrueshme	%
Ndërtesa	5
Makineri dhe pajisje	20
Automjete	20
Pajisje zyre dhe të tjera	20
Kompjutera dhe pajisje IT	25

Jetëgjatësia e aktiveve dhe vlera e mbetur rishikohet në çdo datë raportimi.

3.2 Llogari e kërkesa të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3.3 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.4 Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë tërjedhëse në monedhën Lek dhe Euro.

3.5 Zhvlerësimi

(i) *Aktivet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyre individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyre të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrtet nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) *Aktivet jo-financiare*

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një norme skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.7 Veprimet në monedhë të huaj

Veprimet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit sipas kursit të Bankës së Shqipërisë. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikembehën në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi zyrtar i këmbimit për Euro dhe Lek në fund të vitit paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Kursi Mesatar	Kursi Vjetor	Kursi Mesatar	Kursi Vjetor
EUR	138.84	137.28	138.98	140.14
USD	126.00	125.79	105.48	114.23

3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

Të ardhurat njihen nëse ka mundësi që të realizohen flukse të ardhshme hyrëse dhe këto flukse mund të maten në mënyrë të besueshme.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar në ligjin në fuqi për "Tatimin mbi fitimin" Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshihet të gjithë barrën për vitin korrent. Tatimi mbi fitimin llogaritet si 15 % e të ardhurave të tatueshme si është përcaktuar në SKK dhe legjislacionin Shqiptar.

3.10 Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur duke u mbështetur në parimin e vijueshmërisë.

3.11 Përfitimet e punonjësve

Pagat, rrogat, kontributet ndaj shtetit dhe sigurimet, leja e zakonshme dhe jo, shpërblimet, përfitimet jo monetare (si p.sh shërbimet shëndetësore) janë përlogaritur në vitin kur këto shërbime janë kryer ndaj punonjësve të Shoqërisë.

3.12 Krahasimet

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur duke u mbështetur në parimin e krahasueshmërisë.

3.13 Menaxhimi i riskut financiar

Aktiviteti i kompanisë është i ekspozuar kundrejt disa risqeve financiare si: risku i kursit të këmbimit, risku i kredisë dhe risku i përqindjes së interesit. Menaxhimi i riskut financiar drejtohet dhe fokusohet në paparashikueshmërinë e e tregut financiar dhe synon të minimizojë efektet potenciale të papëlqyeshme.

(i) Risku nga kursi i këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euro-n. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për tu mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme.

(ii) Risku i kreditit

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë nëse klientët ose palët e tjera nuk përmbushin detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë. Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është kryesisht i influencuar nga karakteristikat individuale të çdo klienti. Shoqëria krijon një fond provigjoni për zhvlerësim i cili përfaqëson vlerësimet e shoqërisë për humbjet e ndodhura në lidhje me llogaritë e arkëtueshme bazaar tërësisht në humbjet specifike të lidhura me ekspozime individualisht të rëndësishme.

(iii) Risku i përqindjes së interesit

Të ardhurat e shoqërisë dhe fluksi monetar operues janë thellësisht të pavarura nga ndryshimet në treg të normës së interesit. Kompania nuk ka asete që ndikohen në mënyrë domethënëse nga përqindja e interesit.

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Banka	16,956,379	10,119,848
Arka	789,950	-
TOTALI	17,746,329	10,119,848

Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2015

Llogaritë rrjedhëse bankare janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Banka Rajfeisen Leka	271,998	3,608,739
Banka Rajfeisen Euro	18,378,643	6,198,601
Banka Rajfeisen USD	17,853	14,584
Banka Kombëtare Tregtare Euro	289,885	295,924
31 dhjetor 2015	16,956,379	10,119,848

5. Llogari të arkëtueshme

Llogarite e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Klientë për shitje dhe shërbime	63,972,109	53,945,820
TOTALI	63,972,109	53,945,820

Llogarite e arkëtueshme kategorizohen si llogari as të vonuara dhe as të provigjonuara

6. Llogari të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
TVSH e arkëtueshme	250,488	447,320
TOTALI	250,488	447,320

7. Inventari

	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Mallra për shitje	116,318	32,191
TOTALI	116,318	32,191

Invetari më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhet nga artikuj që tregtohen nga kantina e Shoqërisë, e cila është në shërbim të studentëve.

Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2015

8. Aktive aftagjata materiale

	Ndertesa Lekë	Pajisje Informatike Lekë	Pajisje Zyre Lekë	Të tjera Lekë	Total Lekë
Kosto					
Në 01 Janar 2014	8,014,142	3,194,949	9,265,889	4,922,907	25,397,887
Blerje	428,776	120,480	789,840	273,154	1,612,250
Në 31 Dhjetor 2014	8,442,918	3,315,429	10,055,729	5,196,061	27,010,137
Në 01 Janar 2015					
Në 01 Janar 2015	8,442,918	3,315,429	10,055,729	5,196,061	27,010,137
Blerje	90,600	104,590	-	85,660	280,850
Në 31 Dhjetor 2015	8,533,518	3,420,019	10,055,729	5,281,721	27,290,987
Amortizim i akumuluar					
Në 01 Janar 2014	0	254,147	948,478	414,524	1,617,149
Amortizimi për vitin	974,333	765,321	1,821,450	956,307	4,517,411
Në 31 Dhjetor 2014	974,333	1,019,468	2,769,928	1,370,831	6,134,560
Në 01 Janar 2015					
Në 01 Janar 2015	974,333	1,019,468	2,769,928	1,370,831	6,134,560
Amortizimi për vitin	833,299	600,138	1,457,160	782,178	3,672,775
Në 31 Dhjetor 2015	1,807,632	1,619,606	4,227,088	2,153,009	9,807,335
Vlera kontabël neto					
Në 01 Janar 2014	8,014,142	2,940,802	8,317,411	4,508,383	23,780,738
Në 31 Dhjetor 2014	7,468,585	2,295,961	7,285,801	3,825,230	20,875,578
Në 31 Dhjetor 2015	6,725,886	1,800,413	5,828,641	3,128,712	17,483,652

Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2015

9. Aktive Afatgjata Jo-materiale

	Licensa Lekë	Total Lekë
Kosto		
Në 01 Janar 2014	-	-
Blerje	4,967,000	4,967,000
Shërbime/Nxjerrje jashtë përdorimit	(3,616,000)	(3,616,000)
Në 31 Dhjetor 2014	1,351,000	1,351,000
Në 01 Janar 2015	1,351,000	1,351,000
Blerje	-	-
Në 31 Dhjetor 2015	1,351,000	1,351,000
Amortizim i akumuluar		
Në 01 Janar 2014	-	-
Amortizimi për vitin	607,950	607,950
Në 31 Dhjetor 2014	607,950	607,950
Në 01 Janar 2015	607,950	607,950
Amortizimi për vitin	202,650	202,650
Në 31 Dhjetor 2015	810,600	810,600
Vlera kontabël neto		
Në 01 Janar 2014	-	-
Në 31 Dhjetor 2014	743,050	743,050
Në 31 Dhjetor 2015	540,400	540,400

10. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve me 31 dhjetor 2015 është 598,204 lekë (2014 - 224,113 lekë), dhe përbëhet nga detyrime ndaj furnitorëve vendas për aktivitetin e shoqërisë.

11. Të pagueshme ndaj punonjësve

Të pagueshme ndaj punonjësve përbëhen nga pagat dhe honoraret të palikujduara në shumën 3,147,252 lekë, 2014 (2,402,110 lekë).

12. Detyrimet Tatimore

	31 dhjetor 2015 (Shuma në LEK)	31 dhjetor 2014 (Shuma në LEK)
Detyrimet		
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	796,385	517,583
Tatimi mbi të ardhurat personale	407,107	103,090
Tatim në burim	144,000	21,000
Tatim mbi fitimin	1,304,599	900,762
TOTALI	2,652,091	1,542,445

Pesqyrat Financiare
31 dhjetor 2015

13. Të ardhura të shtyra

Të ardhurat për vitin 2015 janë llogaritur, sipas faturimeve të kryera në (Nëntor dhe Dhjetor) dhe të deklaruar, si me poshtë:

	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Totali i faturimeve	93,294,862	58,771,533
Të ardhura për vitin	23,323,721	14,692,863
TOTALI	69,971,161	44,078,649

14. Kapitali i paguar

	Kapitali i regjistruar (LEKË)	Pjesëmarrja në %
Ardi Bezo	30,000	30.00%
Ylber Bezo	40,000	40.00%
Nedre bezo	10,000	10.00%
Bledi Bezo	20,000	20.00%
Totali	100,000	100.00%

Nuk ka patur asnjë ndryshim në strukturën dhe vlerën e kapitalit gjatë vitit 2015.

15. Shitje neto

Të ardhurat janë njohur sipas periudhave të faturimit si me poshtë:

	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Të ardhura nga tarifat vjetore të studimit për periudhën Janar – Shtator	47,312,649	35,499,444
Të ardhura nga tarifat vjetore të studimit për periudhën Shtator - Dhjetor	23,323,721	14,692,863
TOTALI	70,636,370	50,192,327

16. Shpenzime personeli

	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Pagat e personelit	33,994,030	15,968,544
Shpenzimet për sigurime	4,131,711	1,816,496
TOTALI	38,125,741	17,785,040

Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2015

17. Shpenzime të tjera

	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Taksa Lokale	25,120	25,120
Telefon	518,146	467,765
Qera	5,137,440	4,902,000
Energji	1,132,337	950,396
Kancelari	1,014,311	559,310
Shpenzime për aktivitete shkencore e të tjera	1,648,103	374,510
Reklama	3,278,015	8,701,753
Shpenzime për mirëmbajtje ndërtese	1,484,090	32,750
Shërbim Kontabiliteti	510,000	330,000
Shpenzime Akreditimi	-	4,240,500
Shpenzime të tjera	2,006,704	1,515,749
TOTALI	18,754,266	22,099,852

18. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin llogaritet si me poshte vijon:

	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2014 (Shuma në lekë)
Të ardhura	74,528,878	51,633,696
Shpenzime	60,396,890	45,349,684
Rezultati i Ushtrimit	14,131,988	6,284,212
Shpenzime të pazbritshme	13,984	737,774
Rezultati Taimor	14,145,972	7,021,986
Tatim i fitimit (15%)	2,121,896	1,053,298

19. Ngjarjet pas dates se raportimit

Nuk ka ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat bëhen rregullime apo për të cilat duhet të jepen shënime shpjeguese.